



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË
SEKTORI I MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN

Korçë, më datë 30/11/2023

Proces-verbal nr. 1

Bazuar në LIGJIN Nr 139/ 2015, neni 3, pika “dh”, në datën 6 tetor – 12 tetor 2023 në kuadrin e procesit të “Buxhetimit me Pjesëmarrje”, për të diskutuar lidhur me kërkesa dhe shqetësime të kryetarëve dhe banorëve të fshatrave si dhe Paketën Fiskale 2024, u zhvilluan takime të njëpasnjëshme me kryetarët e Njësive Administrative të Bashkisë Korçë, si edhe me banorë të çdo njësie.

Pjesë e panelit të diskutimit ishin z. Sotiraq Filo Kryetar Bashkia Korçë, Besa Spaho Zv. Kryetare Bashkia Korçë, Soniel Prifti Drejtor i Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Korçë, Ilir Dinellari Drejtor i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike.

Fjalën e mori i pari z. Sotiraq Filo, i cili listoi disa nga investimet e mëdha të realizuara por edhe në proces në Njësitë Administrative. Mes tyre përmendi projektet: përmirësimi i infrastrukturës rrugore në disa fshatra të Bashkisë Korçë, ndërhyrjet e njëpasnjëshme në rrugët e parcelave në të gjithë fshatrat e bashkisë, ndriçimin publik etj. Në vazhdim ai foli edhe për rëndësinë e marrjes së mendimeve të kryetarëve dhe banorëve të fshatrave për investimet gjatë vitit të ardhshëm në mënyrë që t’u jepet prioritet atyre ndërhyrjeve që vetë ata i shohin si më emergjente.

Pasi u njohën me shpjegimet përkatëse për “Buxhetimin me Pjesëmarrje” dhe mundësinë që ata kanë për të zgjedhur vetë ato ndërhyrje që bashkia duhet t’i shohë me përparësi, kryepleqtë patën mundësinë për të parashtruar kërkesat e tyre dhe për të vendosur prioritetet sa i takon fokusit të investimeve të Bashkisë Korçë për vitin 2024. Kërkesat e tyre u mbajtën shënim paralelisht dhe të detajuara sipas grafikut të takimeve të zhvilluara më poshtë.

Takimet e zhvilluara:

- 6 tetor - Njësia Administrative Bulgarec
- 6 tetor - Njësia Administrative Drenovë
- 10 tetor - Njësia Administrative Voskop
- 10 tetor - Njësia Administrative Voskopojë dhe Lekas
- 12 tetor - Njësia Administrative Mollaj
- 12 tetor - Njësia Administrative Vithkuq

Bazuar në kërkesat e ngritura nga kryetarët dhe banorët e fshatrave u listuan nevojat e tyre si më poshtë:

BULGAREC

- **Fshati Belorta:** Asfaltimi i rrugës lidhëse të fshatit me aksin nacional
- **Fshati Barç:** Përmirësimi i rrjetit të ndriçimit
- **Fshati Çiflig:** Sistemimi i kanalizimeve të ujërave të zeza
- **Fshati Bulgarec:** Asfaltim i rrugës kryesore të fshatit
- **Fshati Kuç i Zi:** Sistemimi i rrjetit të kanalizimeve të ujërave të zeza
- **Fshati Neviçisht:** Urë lidhëse mes fshatrave
- **Fshati Biranj:** Asfaltimi i rrugës kryesore
- **Fshati Shamoll:** Mungesa e ndriçimit publik
- **Fshati Melçan:** Asfaltimi i rrugëve të brendshme të fshatit
- **Fshati Lumalas:** Mjetet me tonazh të rëndë dëmtojnë rrugën

Në fshatin Belorta (XXX) Është bërë një punë shumë e mirë deri tani nga Bashkia Korçë në fshatin tonë, por ka ende vend për përmirësim. Një nga problemet tona kryesore është asfaltimi i rrugës lidhëse të fshatit me aksin nacional. Kemi probleme me ujësjellësin ndaj duam që ta marrë UKKO në administrim. Për rrugët e parcelave është bërë një punë e mirë por kemi akoma edhe disa rrugë të paçakulluar.

Në fshatin Barç (XXX) Në fshatin tonë duhet të vendosen ndriçues në të gjithë lagjen e sipërme. Gjithashtu një problem tjetër është ura e fshatit në lagjen e poshtme, e cila është e amortizuar dhe ka nevojë për ndërhyrje.

Në fshatin Çiflig (XXX) Faleminderit që na bëni pjesë të këtyre takimeve! Në fshatin tonë ka ende punë për të bërë duke filluar që nga sistemimi i kanalizimeve të ujërave të zeza. Po ashtu duhet ndërhyrje emergjente për pastrimin e unazës së fshatit, po afron dimri dhe duhet të shmangim problemet. Nevojiten edhe 4 ndriçues për të plotësuar ndriçimin publik në fshat.

Në fshatin Bulgarec (XXX) Investimet e bëra në këtë fshat kanë qenë brenda pritshmërive tona dhe ne jemi të kënaqur. Prioritet për në vazhdim është infrastruktura rrugore. Është shumë i nevojshme asfaltimi i rrugës kryesore të fshatit, si edhe disa rrugëve të tjera brenda fshatit.

Në fshatin Kuç i Zi (XXX) Një nga problemet tona më shqetësues është kanalizimi i ujërave të zeza, duhet ndërhyrje për të sistemuar rrjetin ekzistues.

Në fshatin Neviçisht (XXX) Ju falenderojmë për të gjitha investimet që janë bërë në fshatin tonë. Ne kemi të nevojshme që në fshat të ndërtohet një urë tek përroi për t'u lidhur me fshatin Belorta. Gjithashtu nevojiten edhe tre ndriçues për të kompletuar ndriçimin publik në të gjithë fshatin.

Në fshatin Biranj (XXX) Faleminderit për të gjitha investimet dhe punët e bëra në fshatin Biranj. Ka akoma punë për të bërë, të cilat jam i sigurt se do të gjejnë zgjidhje. Si fillim duam që të bëhet asfaltimi i rrugës kryesore të fshatit Biranj, mungojë gjithashtu disa ndriçues në lagjen e re. Një problem tjetër shqetësues për ne është sistemimin i kanalizimeve të ujërave të zeza përgjatë rrugës kryesore.

Në fshatin Shamoll (XXX) Jemi shumë të kënaqur me të gjitha investimet që janë bërë në fshatin tonë, por ka ende disa problematika që na shqetësojnë. Tek unaza e fshatit mungon ndriçimi publik, ju lutem të merren masa sa më parë. Gjithashtu në hyrje të fshatit mungojnë trotuaret.

Në fshatin Melçan (XXX) Në fshatin tonë problem mbetet ujësjellësi dhe ujërat e zeza. Gjithashtu kërkojmë asfaltimin e rrugëve të brendshme të fshatit.

Në fshatin Lumalas (XXX) Problem shumë i rëndësishëm për ne mbeten makinat e tonazhit të rëndë që kalojnë në fshat, po dëmtojnë shumë rrugën. Gjithashtu kanali i Vendroikut na ka hapur sërish probleme, tubat janë thyer. Shpresojmë që kërkesat tona të merren parasysh.

DRENOVË

- **Fshati Qatrom:** Nevoja e ndërtimit të një këndi sportiv.
- **Fshati Boboshticë:** Ndërhyrje për ndriçimin publik
- **Fshati Turan:** Çakullimi i rrugëve dytësore të fshatit
- **Fshati Ravonik:** Vendosija e 14 ndriçuesve LED në fshat
- **Fshati Mborje:** Amortizimi i disa prej rrugëve
- **Fshati Drenovë:** Kanalizimi i ujërave të zeza

Në fshatin Qatrom (XXX) Për çakullimin e rrugëve të parcelave dhe pastrimin e kanaleve është bërë një punë shumë e mire. Jemi të kënaqur me ndërhyrjet që janë bërë në fshat. Është shumë i nevojshëm ndërtimi i një këndi sportiv, një kërkesë e vazhdueshme e të rinjve për të kaluar kohë në mënyrë aktive.

Në fshatin Boboshticë (XXX) Në fshatin Boboshticë kemi probleme me ndriçimin, si edhe kërkojmë të bëhet asfaltimi i rrugës së Zapeve.

Në fshatin Turan (XXX) Faleminderit për ndërhyrjet e bëra në fshatin tonë. Kërkojmë nga ju të shtohen ambientet çlodhëse në qendër të fshatit dhe ato për moshën e tretë. Gjithashtu e nevojshme është ndërhyrja tek rrugët dytësore të fshatit.

Në fshatin Ravonik (XXX) Ju falenderojmë shumë për asfaltimin e rrugës kryesore të fshatit, një kërkesë e vazhdueshme e jona që më në fund u realizua. Në fshatin tonë kemi mungesë të ndriçimit publik, mungojnë rreth 14 ndriçues LED.

Në fshatin Mborje (XXX) Faleminderit për punën e bërë në fshatin tonë, por kemi ende kërkesa edhe për këtë vit. E nevojshme është ndërhyrja në infrastrukturë, disa rrugë të bëhen me asfalt dhe disa të tjera me kalldrëm.

Në fshatin Drenovë (XXX) Në fshatin tonë ka mungesë të ndriçuesve, si edhe probleme me rrjetin e kanalizimeve. Rruga nga varrezat tek kthesa mbetet gjithashtu një problem shumë i madh.

VOSKOP

- **Fshati Voskop:** Asfaltimi i rrugëve të fshatit
- **Fshati Vinçan:** Ndërhyrje në rrjetin e kanalizimeve të kanaleve anësorë të rrugës
- **Fshati Goskovë:** Zgjerimi i rrugëve të fshatit
- **Fshati Dërsnik:** Ndërhyrje në asfaltimin e rrugës lidhëse mes Polenës dhe Dërsnikut
- **Fshati Damjanec:** Plotësimi i ndriçuesve publik në fshat
- **Fshati Polenë:** Betonizimi i përroit të fshatit

Në fshatin Voskop (XXX) Ju falenderojmë për punët që janë bërë por edhe për ndërtimin e urave, është bërë një punë shumë e mirë. Problemi kryesor për banorët e fshatit është asfaltimi i disa prej rrugëve. Mungon ndriçimi publik si edhe koshat për mbeturina. Kanalizimi i ujërave të zeza mungon në një pjesë të fshatit, ju lutemi të ndërhyni sa më parë.

Në fshatin Vinçan (XXX) Në fshatin tonë problem është kanalizimi i kanaleve anësorë të rrugës. Problem janë edhe ujërat e zeza në lagjen poshtë, duhet një ndërhyrje e menjëhershme. Janë gjithashtu edhe dy prita malore në fshatin Vinçan që duhen bërë sa më parë.

Në fshatin Goskovë Lart: (XXX) Rrugët e fshatit Goskovë lart janë me një kalim, ndaj kërkojmë shtimin e tombinove për të bërë të mundur zgjerimin e tyre.

Në fshati Dërsnik (XXX) Jemi shumë falenderues për investimet e bëra në fshatin tonë, por kërkojmë asfaltimin e rrugës lidhëse mes Polenës dhe Dërsnikut, është e vetmja problematikë shumë shqetësuese për ne.

Në fshatin Damjanec (XXX) Në pjesën më të madhe të fshatit mungon ndriçimi publik, shpresojmë që kjo problematikë të zgjidhet sa më parë. Kemi 2/3 përrenj në fshat tek të cilat duhet të vendosen tombino në mënyrë që të vejë traktori deri tek tokat bujqësore ku punojmë.

Në fshatin Polenë (XXX) Rrugët e parcelave falë ndërhyrjeve që ka bërë bashkia kanë qenë në gjendje mjaft të mirë dhe na kanë ndihmuar shumë në punët e bujqësisë. E shohim shumë të nevojshme betonizimin e përroit të fshatit, si edhe sistemimin e trotuarëve që kanë mbetur pa përfunduar që kur u bë asfaltimi i rrugëve.

VOSKOPOJË DHE LEKAS

- **Fshati Voskopojë:** Ndërhyrje në rrugët e kalldrërta
- **Fshati Gjonomadh:** Asfaltimi i rrugëve brenda fshatit
- **Fshati Lekas:** Mungon energjia elektrike
- **Fshati Shkozan:** Ndërhyrje për sistemimin e rrugës që lidh fshatin Shkozan me rrugën kryesore

Në fshatin Voskopojë (XXX) Voskopoja ka nevojë të menjëhershme për sistemimin e rrugëve me kalldrëm, si edhe të zëvendësohet ndriçimi publik në ato vende që ka nevojë. Këto janë probleme që duhen zgjidhur sa më parë sepse Voskopoja është fshat që pret turistë nga Shqipëria dhe bota në çdo muaj të vitit.

Në fshatin Gjonmadh (XXX) Problemi më madhor i fshatit Gjonmadh është asfaltimi i rrugëve të brendshme. Është një kërkesë e vazhdueshme nga banorët që shpresojmë të marr zgjidhje sa më parë.

Në fshatin Lekas (XXX) Problem në fshatin Lekas kemi me linjën e furnizimit me energji elektrike. E nevojshme është gjithashtu një ndërhyrje për sistemimin e urës së Lekasit, e cila është e dëmtuar.

Në fshatin Shkozan (XXX) Sistemimi i rrugës që lidh fshatin tonë me rrugën kryesore, është një investim shumë i nevojshëm dhe me rëndësi për banorët e fshatit tonë. Uji i pijshëm është gjithashtu problem sepse është me vetmenaxhim nga fshati.

MOLLAJ

- **Fshati Dvoran:** Çakullimi i disa rrugëve të parcelave
- **Fshati Boboshticë:** Sistemimi i rrjetit të kanalizimeve të ujërave të zeza
- **Fshati Kamenicë:** Asfaltimi i disa rrugëve brenda fshatit.

Në fshatin Dvoran (XXX) Është bërë një punë shumë e mirë për asfaltimin e rrugëve brenda fshatit dhe për këtë ju falenderojmë. Disa rrugë parcelash kanë nevojë për çakullim. Fusha e sportit gjithashtu duhet mirëmbajtur dhe bërë funksionale, në mënyrë që të rinjtë e fshatit të kalojnë më shumë kohë në mënyrë sa më produktive.

Në fshatin Boboshticë (XXX) Problem në fshat kemi me ujërat e zeza, si edhe me disa rrugë që janë pa ndriçim. Ju lutemi të merren masa sa më parë.

Në fshatin Kamenicë (XXX) Punën në fushë këtë sezon e kemi pasur më të lehtë për shkak se rrugët e parcelave janë sistemuar, por ka akoma disa të cilat kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme sepse na pengojnë punën. Ka mungesë të ndriçuesve në fshat. Tre rrugë në lagje duam që të asfaltohen, si edhe të bëhet një lulishte për të kaluar kohën në një ambient të gjelbëruar.

VITHKUQ

- **Fshati Vithkuq:** Probleme me kanalet kullues dhe vaditës, sistemimi i rrugëve me kalldrëm, sistemimi i kanalizimeve
- **Fshati Lubonjë:** Përfundim i rrugës që lidh fshatin Lubonjë me Ersekën
- **Fshati Leshnjë:** Sistemim i rrjetit të ujërave të zeza

Në fshatin Vithkuq (XXX) Vazhdojmë të kemi probleme me kanalet kullues dhe vaditës, të cilat mbeten shqetësim për banorët. Po ashtu sistemimi i rrugëve me kalldrëm është një tjetër kërkesë e jona.

Në fshatin Lubonjë (XXX) Rruga që lidh fshatin tonë me Kolonjën kërkon një sistemim në një gjatësi prej 500 metrash, pasi kjo e bën më të lehtë lidhjen me këtë bashki. Kërkojmë që shërbimi ujësjellës të administrohet nga UKKO për të pasur një menaxhim më të mirë.

Në fshatin Leshnjë (XXX) Jemi shumë të kënaqur me rrjetin e ujit të pijshëm, por nuk ka ujë në varreza, ju lutem të ndërhyet për këtë kërkesë. Një problem tjetër në fshatin tonë mbetet sistemimi i ujërave të zeza. Kërkojmë një ndërhyrje të menjëhershme sepse është një problem shqetësues për të gjithë banorët.

Njësia Administrative Bulgarec



Njësia Administrative Drenovë



Njësia Administrative Voskop



Njësia Administrative Voskopojë dhe Lekas





Njësia Administrative Mollaj



Njësia Administrative Vithkuq

